


ÇKA DUHET TË DINI SI I DËMTUAR NË LËNDË PENALE?



KUR MUND TË PARAQITENI SI I DËMTUAR NË LËNDË PENALE?

Nëse jeni viktimë e një veprë penale ose jeni person të cilit i është shkelur e drejta personale ose e drejta e pronës me veprën penale dhe që merr pjesë në procedurën penale me përfshirje në ndjekjen penale ose me qëllim të realizimit të kërkesës pronësore-juridike.

CILAT JANË TË DREJTAT TUAJA SI I DËMTUAR?

Kur jeni i dëmtuar i keni këto të drejta për të cilat organet e procedurës patjetër duhet t'ju njoftojnë:

- ta përdorni gjuhën tuaj dhe të shfrytëzoni përkthyes në qoftë se nuk e kuptoni gjuhën në të cilën zhvillohet procedura;
- të parashtroni propozim për realizimin e kërkesës pronësore-juridike;
- të keni person të autorizuar;
- të tregoni fakte dhe të propozoni prova;
- të merrni pjesë në seancën e provave, si dhe në seancën kryesore dhe të merrni pjesë në procedurën e dëshmimit;
- pas përfundimit të procedurës hetimore t'i shqyrtoni dokumentet dhe lëndët të cilat shërbejnë si prova;
- të parashtroni ankesë;
- të parashtroni propozim për ndjekje dhe akt padi private;
- të njoftoheni për mosmarrjen e ndjekjes penale ose për çdo heqje dorë nga ndjekja penale nga ana e prokurorit publik dhe të parashtroni ankesë ndaj vendimit të këtille;
- të kërkonti kthimin në gjendjen paraprake;
- t'u respektohet e drejta e privatësisë dhe
- të merrni pjesë në procesin e ndërmjetësimit.

PËR ÇKA MUND TË PARASHTRONI KËRKESË PRONËSORE-JURIDIKE?

Kërkesa pronësore të cilën e parashtroni si i dëmtuar, mund të lidhet me kompensimin e dëmit, kthimin e sendeve ose me shfuqizimin e një pune të caktuar juridike, si për shembull kontratat e ndryshme që janë lidhur si rezultat i veprës penale etj.

ÇKA NË QOFTË SE NË LËNDËN PENALE NUK MUND TË VENDOSËT PËR KËRKESËN TUAJ PRONËSORE-JURIDIKE SI I DËMTUAR?

Nëse gjykata të akuzuarin e shpall fajtor, ajo vendos në mënyrë të plotë ose të pjesërishtme për kërkesën Tuaj juridike-pronësore. Nëse gjykata për kërkesën Tuaj pronësore-juridike vendos në mënyrë të pjesërishtme, atëherë për shumën e mbetur të kërkesës juridike-pronësore do t'ju udhëzojë që të realizoni kontest para gjykatës kompetente. Mirëpo, mund të ndodhë që edhe përkundër faktit që gjykata të akuzuarin e ka shpallur fajtor, ajo të mos ketë dëshmi të mjaftueshme në procedurën penale për të marrë vendim edhe për kërkesën Tuaj juridike-pronësore. Duke pasur parasysh faktin se sigurimi plotësues i këtyre dëshmive mund të shkaktojë prolongim të procedurës penale, gjykata, edhe në këtë rast do t'u udhëzojë që kërkesën pronësore-juridike ta realizoni në kontest përpara gjykatës civile.

Në situatën kur gjykata nuk do ta shpallë të akuzuarin fajtor, atëherë as që do të vendosë për kërkesën Tuaj pronësore-juridike dhe gjithsesi do t'u udhëzojë se atë mund ta realizoni në kontest para gjykatës civile.